



---

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT  
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

**QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA**

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE  
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE  
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me Rregulloren 2001/9, neni 1.3 pika (ç) mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,  
Duke pasur parasysh neni 4.9 të Ligjit 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë,  
Me qëllim të ofrimit të mundësisë së ri aplikimit për pensionet e aftësisë së kufizuar nga kërkuesit potencial, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**PROPOZIM NR. 9/2005**

**PËR**

**NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 9/2004  
PËR PROCEDURAT E PARAQITJES SË KËRKESËS PËR PENSION TË AFTËSISË  
SË KUFIZUAR**

**Neni 1**

- 1.1** Pas nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 9/2004, shtohet neni 8 me titull **“Procedurat e riaplikimit”**, i cili do të ketë këtë përmbajtje:
- 1.2** Çdo aplikues për pensionin e aftësisë së kufizuar në qoftë se i refuzohet kërkesa nga autoriteti përkatës, në përputhje me kushtet dhe kriteret e përcaktuara me Ligjin për Pensionet e Aftësisë së Kufizuar dhe aktet e tjera nënligjore e ka të drejtën e riaplikimit për këtë pension.

- 1.3** Riaplikimi për pensionin e aftësisë së kufizuar, mund të bëhet nga aplikuesi vetëm pas një viti nga dita e parashtrimit të kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar.
- 1.4** Në raste të veçanta aplikuesi për pensionin e aftësisë së kufizuar, mund të riaplikojë edhe pa u mbushur një vit nga dita e paraqitjes së kërkesës, por jo me parë se gjashtë (6) muaj nga dita e paraqitjes së kërkesës për pensionin e aftësisë së kufizuar.
- 1.5** Riaplikimi pas gjashtë (6) muajve për pensionin e aftësisë së kufizuar, nga dita e paraqitjes së kërkesës, mund të bëhet kur janë në pyetje sëmundjet me zhvillim të shpejtë të cilat dëmtojnë shumë shëndetin dhe zvogëlojnë tej mase aftësinë e punës.
- 1.6** Sëmundjet të cilat kanë një zhvillim të shpejtë, të cilat dëmtojnë rëndë shëndetin si dhe në masë të lartë zvogëlojnë aftësitë e punës sipas Komisionit Mjekësor të MPMS-së janë:
- Karcinomat e të gjitha organeve të vërtetuara me ekzaminim histopatologjik,
  - Insulti cerebrovaskular,
  - Status post infraktus myocardi,
  - Insuficienca renale terminale,
  - Hemopatitë,
  - Politraumat (gjatë aksidenteve, amputimet e ekstremiteteve),
  - Epilepsia me kriza të shpeshta,
  - Psikozat e rënda,
  - Ciroza hepatike e dekompenzuar,
  - Arthriti rheumetoid gr.III-IV,
  - Morbus Perthes,
  - Dëmtimet posttraumatike të syrit dhe sëmundje të tjera të syrit që dëmtojnë rëndë të pamurit,
  - Dhe sëmundje e tjera që dëmtojnë rëndë shëndetin.

## **Neni 2**

**2.1.** Neni 8 i Udhëzimit Administrativ nr. 09/2004 për Procedurat e Paraqitjes së Kërkesës për Pension të Aftësisë së Kufizuar bëhet ***neni 9***.

## **Neni 3**

**3.1.** Propozimi nr. 9/2005 për ndryshimet dhe plotësimet e Udhëzimit Administrativ nr. 9/2004, hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet nga **01.07.2005**

**Prishtinë, Korrik 2005**

**Ministri i MPMS-së**  
***Ibrahim Selmanaj***

---